



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK.nr.499/2022**

**Datë: 27 dhjetor 2022**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 5 të Rregullores nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Themelohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për ekspert gjyqësor, në përbërjen si në vijim:
  1. Adnan Konushevci, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë/kryetar i komisionit;
  2. Gazmend Bahtiri, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtar i komisionit;
  3. Migjen Kastrati, gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë/anëtar i komisionit;
  4. Sami Gashi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren/anëtar rezervë;
  5. Sabedin Mushica, gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan/anëtar rezervë i komisionit.
- II. Komisioni ka mbështetje administrative dhe profesionale nga Njësia për Inspektim Gjyqësor.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

**A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, ka shpallur konkurs për certifikimin dhe emërimin e ekspertëve gjyqësor dhe ka themeluar komisionin për vlerësimin e aplikacionit të kandidatit për ekspert gjyqësor.

Me qëllim të shqyrtimit të ankesave eventuale të kandidatëve për ekspert gjyqësor, konform nenit 5 të Rregullores nr. 03/2022 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet dhe Shpërblimin e Ekspertëve Gjyqësor, Këshilli themelon Komisionin për shqyrtimin e ankesave në përbërje si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Anëtarëve të komisionit;
- Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.

**Albert ZOGAJ,**  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

